

VENDIM
Nr.733, datë 1.9.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 10 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591 datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Përjashtimisht, lejohen Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve (DPUK), si autoritete kontraktore, të vijojnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve, përkatësisht, për objektet “Riparimi i shtresave rrugore, në aksin Tiranë–Dajt, segmenti pranë antenave” dhe “Linja e transferimit të Kafarajt.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës – Kanalizimeve (DPUK), dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha